



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 583/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.07.2017, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "CURRI" sh.p.k., në procedurën e prokurimit, "Procedurë e Hapur", me objekt "Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga "Besa" – "Siri Kodra" – "Zenel Bastari" – "Haki Rexhep Kodra" (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike", me nr. REF-02194-04-03-2017, me fond limit 160,045,913 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "VICTORIA INVEST" sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "SIRETA 2F" sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik "CURRI" sh.p.k..

Adresa: Rr. "Kajo Karafili", Pall. "Bimbashi" 8/2, Kati II-të, Ap. 2 B, Tiranë.

Operatori ekonomik "VICTORIA INVEST" sh.p.k.

Adresa: Lagjia 28 Nëntori, Rruga "11 Nëntori", Elbasan.

Operatori ekonomik "SIRETA 2F" sh.p.k.

Adresa: Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë.
Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nd.2, kodi postar 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.04.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, "Procedurë e Hapur", me objekt "Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga "Besa" – "Siri Kodra" – "Zenel Bastari" – "Haki Rexhep Kodra" (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike", me nr. REF-02194-04-03-2017, me fond limit 160,045,913 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 02.05.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 12.05.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|-------|---|---------------------------------|
| i. | "BE-IS" sh.p.k | 122,050,940 lekë, skualifikuar; |
| ii. | "EUROTEOREMA PEQIN" sh.p.k | 127,000,000 lekë, skualifikuar; |
| iii. | BOE "KACDEDJA" sh.p.k & "AGRI CONSTRUCTION" sh.p.k. | 128,036,741 lekë, skualifikuar; |
| iv. | BOE "MELA" sh.p.k & "ALB SHPRESA" sh.p.k. | 130,000,000 lekë, skualifikuar; |
| v. | BOE "SIRETA 2F" sh.p.k & "ARTYKA II" sh.p.k | 133,333,333 lekë, skualifikuar; |
| vi. | "CURRI" sh.p.k | 134,664,788 lekë, skualifikuar; |
| vii. | "ALBAVIA" sh.p.k | 136,140,178 lekë, skualifikuar; |
| viii. | "VICTORIA INVEST" sh.p.k | 147,228,626 lekë, skualifikuar; |
| ix. | BOE "DELTA LAVORI" S.P.A & "COMPANY RIVIERA 2008" | 153,096,684 lekë, skualifikuar; |

II.4. Në datën 12.05.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "CURRI" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

• *Operatori ekonomik "Curri" shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit teknik: "Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm", pasi për mjeken e shoqërisë nuk ka paraqitur Librezën e Punës dhe CV.*

• *Operatori ekonomik "Curri" shpk nuk plotëson pikën 16, germa d) të Kapacitetit teknik: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.", pasi për Autobotin me targë SH4082E nuk ka paraqitur foto.*

• *Operatori ekonomik "Curri" shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/Autobot Uji, pasi për Autobotin me targë TR9983R të deklaruar në shtojcën 9 si i marrë me qera sipas kontratës së qerasë me "Babasi CO" shpk, Nr.23Rep, Nr.16 Kol, datë 18.02.2017, nuk ka paraqitur dokumentacion.*

• *Për të vërtetuar përvojën e suksesshme, shoqëria "Curri" shpk, ka paraqitur kontratat e punës si më poshtë vijon:*

1) *Kontrata e punës me objekt: "Rikonstruksioni I rrugës Libonik-Rrëmbec-Plase, qarku Korce", për të cilën nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit.;*

2) *Kontrata e punës me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës Porcelan-Kionostudio-Surrel", për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim;*

3) *Kontrata e punës me objekt: "Plotësimi i segmentit Dragobi-Valbonë", për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.*

4) Kontrata e punës me objekt: “Rikualifikim urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, njësia bashkiake Nr. 7, për të cilën nuk ka paraqitur Formularin e Vleresimit dhe Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk ka paraqitur foto për çdo mjet të deklaruar sipas Shtojcës 9, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se mjeti Autobotumatriçe e deklaruar në Shtojcën 9, nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar: Leje qarkullimi, Çertifikatën e kontrollit teknik si dhe siguracionin e mjetit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.

II.4.1. Në datën 16.05.2017 operatori ekonomik ankimues ”CURRI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]1. Operatori ekonomik “CURRI“ Sh.pk, nuk ploteson piken 8 te Kapacitetit Teknik: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Pasi për mjeken e shoqërisë nuk ka paraqitur librezën e punës dhe CV.

Sqarim: Arsyeya juaj e refuzimit është absurde. CV, është një deklaram vullnetar e i lire i individit dhe nuk mund të jete asnjehere një kriter skualifikimi. Ne kemi një mjek te punesuar, sipas kriterve ligjore te punesimit, me një kontrate pune, te deklaruar ne organet tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore si dhe ne listepagesat e shoqerise. Libreza e punës, mungon për arsye se ende nuk është terhequr nga institucioni i punes qe e ka leshuar ate fillimisht për te punesuaresh. Por, nuk kuptojme, edhe se çfare do te vertetonin me keto dy dokumente autoriteti kontraktor. Pra, për çfare do i sherbente për te vertetuar CV dhe Libreza e punes???? Nderkohe qe ne kemi paraqitur, dokumente zyrtar, Diplomen e Mjekes leshuar nga Universiteti i Tiranes, licencen e leshuar nga Urdheri i Mjekut, një tjetër dokument zyrtar.

Ndaj, nuk i konsiderojme aspak të mireqena arsyet e refuzimit të dhena nga KVO e autoritetit kontraktor.

2. Operatori ekonomik “CURRI“ Sh.p.k., nuk ploteson piken 16, germa d te kapacitetit teknik: Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit., pasi për autobotin me targe SH 4082 E nuk ka paraqitur foto.

Sqarim; Serisht konsiderojme qe kjo nuk është një arsye për skualifikim. Ne oferten tone janë bashkelidhur te gjith dokumentet zyrtare qe tregojne pronesine e ketij automjetei nga shoqeria “CURRI“ Sh.p.k. dhe autoriteti kontraktor nuk merr ne konsiderate asnje nga dokumentet zyrtare, por kerkon dhe i beson një foto e cila fare lehte mund te punohet apo improvizohet ne photoshop. Është absurditet ky lloj vleresimi e nenvleresimi njekohesisht për dokumentet zyrtare te leshuara nga zyrat e shtetit, te cilat nuk bindin disa anetar te KVO për vertetesine e ketyre dokumenteve.

Ndaj, nuk i konsiderojme aspak të mireqena arsyet e refuzimit të dhena nga KVO e autoritetit kontraktor.

3. Operatori ekonomik “CURRI“ Sh.p.k., nuk ploteson piken 16 te kapacitetit teknik: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9). Autoboti i ujit, pasi për Autobotin me targe

TR9983R te deklaruar ne shtojcen 9 si te marre me qira sipas kontrates se qirase me "BABASI & CO" Sh.p.k.Nr.23Rep, Nr.16 Kol, date 18.02.2017, nuk ka paraqitur dokumentacion.

Sqarim: Po per kete mjet nuk kemi paraqitur dokumentacion pasi nuk e kemi konsideruar te nevojshme paraqitjen, pasi ne kemi autobotin tone ne pronesi te cituar ne piken 2 me lart. Deklarimi i ketij mjetei eshte thjeshte lapsus.

4. Per te vertetuar pervojen e sukseshme, shoqeria "CURRI" Sh.p.k. ka paraqitur kontratat e punes si me poshte: 1. Kontraten me objekt: Rikonstruksioni i rruges Libonik -Rrembec-Plase, Qraku Korce, perte cilen nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit 2. Kontraten me objekt: „Rikonstruksion i rruges Porcelan-Kinostudio-Surrel“, per te cilen nuk ka paraqitur certifikaten e marrjes ne dorezim. 3. Kontraten me objektet: Rikualifikim urban i zones qe kufizohet me rrugen e Duresit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si parku tek ish pista e aviacionit, njesia bashkiake nr.7, per te cilen nuk ka paraqitur formularin e vleresimit dhe certifikaten e marrjes ne dorezim. 4. Kontraten me objekt: Plotesim i segmentt Dragobi Valbone, per te cilen nuk ka paraqitur certifikaten e marrjes ne dorezim.

Sqarim: Po, ju sqarojme qe kontrata e ngjashme 1, e te cituara me siper, nuk ka akt kolaudimi, pasi eshte financim i huaj dhe operohet vetem me "Taking Over Certificate" dhe "Performance Certificate". Kontrata 2 dhe 4 te realizuara me Fondin Shqiptar te Zhvillimit jane brenda periudhes se garancise 2 (dy vjet) dhe nuk leshohet Certificate e marrjes ne dorezim pa mbaruar periudha e garancise. Ne lidhje me kontraten 3, te realizuar me bashkine Tirane, konform ligjit kemi derguar kerkesen zyrtare ne Bashki per pajisjen me formular vleresimi, dhe ky dokument ende nuk eshte leshuar nga Bashkia Tirane.

5. Operatori ekonomik "CURRI" Sh.p.k. nuk ka paraqitur foto per cdo mjet te deklaruar sipas shtojces 9, ç'ka bie ne kundërshtim me DST, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, germa d.

Sqarim: Ne kemi derguar fotot vetem te atyre mjeteve qe diponojme, dhe realisht nuk kuptojme se çfare verteton me kete kerkesë absurde KVO. Automjetet, e deklaruar si ato ne pronesi edhe ato me qira, jane te pajisur me dokumentacion te leshuar nga institucionet shteterore perkatese te cilat vertetojne pronesine e tyre dhe lejet perkatese per qarkullim dhe pagimin e taksave dhe tarifave te nevojshme per te mundesuar operimin e ketyre mjeteve.

6. KVO konstatoi se mjeti Autobotmatrice e deklaruar ne shtojcen 9, nuk eshte i shoqeruar me dokumentacionin e kerkuar leje qarkullimi, certificate e kontrollit teknik si dhe siguracion e mjetit, ç'ka bie ne kundërshtim me DST, kriteret e kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 16, germa a.

Sqarim; Autobotmatrice eshte thjeshte nje çisetrene termike qe sigurone ruajtjen, transportin dhe shperndajen e bitumit ne kushtet e kerkuara te temperatures dhe parametrave te tjere teknik. Per kete pajisje kemi vertetuar pronesine e saj nepermjet dokumentit te zhdoganimit perkates. Njekohsisht kjo pajisje transporohet dhe levizet me kamion te ngarkesave te lehte dhe ne kete rast eshte perdorur Kamioni me Targe SH 3451E, dokumentacionin e te cilit e keni ne dokumentet e ngarkuar. [...]"

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 18765/2 Prot. datë 22.05.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes "CURRI" sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pikave të ankesës së tij, si dhe duke lënë në fuqi të gjitha arsyet e skualifikimit të vendosura nga KVO, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.4.3. Në datën 31.05.2017 pala ankimuese “CURRI” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 12.05.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ”VICTORIA INVEST” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsytet si më poshtë vijon:

[...]• Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk nuk plotëson pikën 2.2 të Kapacitetit teknik: “Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 80,022,957 (tetëdhjetë milion e njëzet e dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 320,091,826 (treqind e njëzet milion e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme, pasi për punën e ngjashme nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

• Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”, pasi për fadromat përvec faturës së zhdoganimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

• Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë;”, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për kompletin e ndihmes së shpejte. [...]”

II.5.1. Në datën 16.05.2017 operatorin ekonomik ankimues ”VICTORIA INVEST” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“I.[...]Në përmbushje të këtij kriteri shoqëria Victoria Invest ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes Nr. prot. 8169/1 datë 26.08.2013 me objekt “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shine, Njësia Bashkiake NR.11 “Faza I” me vlerë totale 208 799 073 (dyqind e tetë mijë e shtatëqind e nentëdhjetë e nente mijë e shtatëdhjetë e tre) leke pa tvsh. Punimet e kryera për këtë kontratë për vitin 2014 2015 2016 referuar faturave tatimore bashkëlidhur kontratës janë:

Gjithashtu kemi paraqitur në tender dhe “proces verbal marrje në dorëzim...” datë 14.04.2016 për objektin “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake NR.11 “Faza I”.

Bashkangjitur ankesës po ju dërgojmë shkresën tonë me lëndë: kërkesë për tu pajisur me procesverbal të marrjes në dorëzim të punimeve...” datë 07.02.2017 protokollin në Bashkinë Tiranë me nr. 5145 dt. 7.2.2017, si dhe kthim përgjigjen e Bashkisë Tiranë me nr. 5145/1 prot datë 20.02.2017, marrë nga neve në datë 21.02.2017, në të cilën bashkia Tiranë na ka pajisur me “proces verbal marrje në dorëzim...” datë 14.04.2016 për objektin “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake NR.11 “Faza I”.

Ky procesverbal për marrjen në dorëzim të punimeve i Bashkisë Tiranë më datë 14.04.2016 është paraqitur në tender . [...].

II.[...]Në përmbushje të këtij kriteri kemi deklaruar në piken 23 dhe 24 te shtojces 9 mjetet Fadrome me goma Fiat Cobeleo E190 Deklarate doganore R 7314, Fadrome me goma FIAT COBELCO Deklarate doganore R 7385. Ne sistem eshte ngarkuar dokumenti ne pdf 2.34 mb me pershkrimin Vic EL 3 fadroma me goma dhe foto ku gjenden fotot dhe deklaratat doganore dhe keto jane te vetmet dokumenta qe vertetojne pronesine e tyre pasi jane mjete qe qarkullojne vetem brenda kantierit dhe nuk targohen Nga ana jone jane paraqitur mjete germimi me goma, te shoqeruar me deklarata doganore. Arsyetimi juaj qe keto mjete duhej te shoqeroheshin me leje qarkullimi, certifikate kontrolli teknik, siguracion, eshte i kundraligjshem pasi keto mjete jane per perdorim ne kantier. Keto mjete jane makinerit renda qe punojne ne kantier dhe nuk ka detyrim ligjor per tu pajisur me leje qarkullimi, siguracion, certifikate kontrolli teknik etj. Fakti qe kane goma nuk do te thote qe kane detyrim ligjor per tu pajisur me leje qarkullimi, siguracion, certifikate kontrolli teknik etj. Ndërsa në lidhje me lejen e qarkullimit, siguracionin dhe kontrollin teknik bëjmë me dije se, keto mjete nuk mund të pajisen me leje të tilla, sepse jane mjete kantieri dhe nuk kane nevojë për leje qarkullimi, siguracion apo kontroll teknik. Autoriteti kontraktor ka kërkuar fadromë të vogël dhe ne kemi vendosm në dispozicion 2 të tilla.[...]

[...]Në përmbushje te këtij kriteri kemi paraqitur fature tatimore nr.116 date 23.02.2015: pershkrimi i mallit kuti e ndihmes se shpejte

CFAKIO-COPE 1

Kuti CFABK -cope 2

Kuti CFA550- cope 4

me shites ALSAFETY dhe bleres Victoria Invest shpk pra sic verehet, shoqeria Victoria Invest shpk ka paraqitur në tender 7 kuti e ndihmes se shpejte, duke plotesuar kriterin e vendosur ne dst pika 16 bashkangjitur keni edhe nje vertetim nga shoqeria ALBSAFETY shpk ju bej me me dije se kompletet e ndihmes se shpejte nuk i kemi paraqitur tek Shtojca 9, pasi ne Shtojcen 9 paraqiten vetem makinerite. Prandaj e dhe Shtojca 9 ka emertimin “Mbi Disponimin e makinerive” , kurse “kompletet e ndihmes se shpejte” jane produkte qe sherbejne per sigurine ne punonjesve ne pune në rast aksidenti. [...]

II.5.2. Në datë 23.05.2017 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k. me anë të shkresës Nr. 18799/2 Prot. datë 22.05.2017., duke e pranuar pjesërisht ankesën e tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, duke marrë shkas nga kontestimet Tuaja, mori në shqyrtim dokumentacionin e shoqërisë “Victoria Invest” shpk objekt ankimimi nga ku rezultoi se:

1. Persa i përket pretendimit Tuaj në lidhje mbi mosparaqitjen e dokumentacionit për kontratat e puneve të ngjashme, ju sqarojme se :

Pas verifikimeve të realizuara në sistemin elektronik të vënë në dispozicion nga APP, KSHA konstatoi se për kontratën e punës me objekt: “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”, nuk është paraqitur Çertifikata e marrjes në dorëzim.

Proces verbali i marrjes në dorëzim, datë 14.04.2016, “Për marrjen në shfrytëzim dhe mirëmbajtje të investimeve në rrjetin e ndriçimit publik dhe disa element që plotësojnë rrjetin e ujësjellësit, KUB e KUZ në objektin “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina”, është proces verbal pjesor, vetëm për kryerjen e punimeve KUB dhe KUZ, i cili nuk vërteteton marrjen e plotë në dorëzim të punimeve.

Nisur nga sa më lart, KSHA gjykon se çdo lloj dokumenti i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka rëndësinë dhe vlerën e vet dhe qëndron i pavarur nga të tjerët. Gjithashtu, në rast se Operatori ekonomik ankimes do të kishte kundërshtime në lidhje me dokumentat e kërkuara për vërtetimin e përvojës së suksesshme, ai mund t'i drejtohej Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, dhe t'i kërkonte sqarime sipas Nenit 42 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) apo mund të paraqiste ankesë në lidhje me dokumentet e tenderit sipas parashikimeve të përcaktuara në Nenin 63 pika 1/1 të LPP.

KSHA gjykon se ky kriter nuk është përmbushur nga Operatori ekonomik duke e konsideruar të drejtë vendimin e marrë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me këtë pikë.

2. Për sa i përket pretendimit Tuaj në lidhje mos paraqitjes së dokumentacionit shoqërues të mjetit "Fadromë Ju bëjmë me dije se:

Referuar DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, pika 16 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesën për "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike. që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9). germa a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet te paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit {leje qarkullimi}. plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera. dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. {te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te qera duhet te jene aktet e çdoganimit ose fatuar tatimore te blerjes.

Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 9643. datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 46, pika 1 germa "b" si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu III. Seksioni II, Neni 26 pika 8, germa "e" si dhe detyrimit ligjor që përcakton neni 58 dhe 113 i Ligjit Nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar). si dhe të nenit 37 Kreu IV, të Udhëzimit Nr.1, datë 18.1.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre" (i ndryshuar), ku përcaktohet si detyrim ligjor pajisja e mjeteve, përfshirë mjetet e ndërtimit (mjetet teknologjike) me dokumentat përkatës si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).

KSHA gjykon se ky kriter nuk është përmbushur nga Operatori ekonomik, pasi nuk janë paraqitur dokumentat shoqëruesë për mjetin e kërkuar "Fadromë me goma", duke e konsideruar të drejtë vendimin e marrë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me këtë pikë.

Gjithashtu, në rast se Operatori ekonomik ankimes do të kishte kundërshtime në lidhje me dokumentat e kërkuara për mjetet që disponon, ai mund t'i drejtohej Autoritetit Kontraktor. Bashkia Tiranë, dhe t'i kërkonte sqarime sipas Nenit 42 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) apo mund të paraqiste ankesë në lidhje me dokumentet e tenderit sipas parashikimeve të përcaktuara në Nenin 63 pika 1/1 të LPP.

Për sa më lart, Ankimesi ka pasur në dispozicion kohë të mjaftueshme për të sqaruar çdo lloj hamendsimi në lidhje me kërkesat e përcaktuar në DST, dhe pretendimi i ngritur në këtë fazë gjykimi nuk është i mbështetur ligjërisht.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron.

3. Për sa i përket pretendimit Tuaj në lidhje Kompletin e Ndhimes së Shpejtë, Ju bëjmë me dije se: KSHA pas verifikimeve të realizuara në sistemin elektronik të vënë në dispozicion nga APP, si dhe

dokumentacionit të sjellë nga operatori ekonomik, mbi faturën tatimore Nr.116, datë 23.02.2015, KSHA konstaton se përshkrimi “Kuti e ndihmës CFAK10”, “Kuti CFABK”, si dhe “Kuti CFAS20” janë të njëjta me “Kompletet e ndihmës së shpejtë”, të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. KSHA gjykon se ky kriter është përmbushur nga Operatori ekonomik.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk. [...]”

II.5.3. Në datën 01.06.2017 pala ankimuese “VICTORIA INVEST” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të cilat janë lënë në fuqi nga KSHA pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 12.05.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- *Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson pikën 3 të Kriterëve të Përgjithshme të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur. Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:*

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme”, pasi në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017, në nenin 4 të saj ‘pjesëmarrja” janë përcaktuar dy vlera të ndryshme të pjesëmarrjes të shprehura në përqindje, përkatësisht për secilën shoqëri cka bie në kundërshtim me Kreut VIII, Neni 74, pika 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

- *Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson pikën 2.2 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 80,022,957 (tetëdhjetë milion e njëzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 320,091,826 (treqind e njëzet milion e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten të kualifikueshme”, pasi referuar kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017 ku paraqiten vlera të ndryshme të pjesëmarrjes së secilit operator të shprehura në përqindje duke e bërë të pamundur përlllogaritjen e vlerave të punës së ngjashme për secilin.*

- *Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson pikën 4 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Një punësim mesatar i të paktën 70 (shtatëdhjetë) personave, për periudhën shkurt 2016 – shkurt 2017, të vërtetuar me”, pasi referuar kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017 ku paraqiten vlera të ndryshme të pjesëmarrjes së secilit operator të shprehura në përqindje duke e bërë të pamundur përlllogaritjen e numrit të punonjësve për secilin.”*

II.6.1. Në datën 19.05.2017 BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për

skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më posht vijon:

“[...]Në rastin konkret shoqëria jonë ka hartuar para noterit publik në Tiranë zonjës Sh.Gj. kontratën e bashkëpunimit nr 3730rep dhe nr2932kol datë 28.04.2017 në të cilën kemi krijuar dhe bashkimin e përkohshëm të shoqërive me shoqërisë "Artyka II" shpk dhe shoqërisë "Sireta 2 F" shpk, kryesuar nga shoqëria "Sireta 2 F" shpk. Me vullnetin e lirë të palëve, shoqëria "Sireta 2F" shpk dhe shoqëria "Artyka II" shpk kanë deklaruar para noterit publik i cili ka përpiluar edhe kontratën e bashkëpunimit se pjesëmarrja në këtë bashkim operatorësh ekonomikë do të jetë 25.2 % për shoqërinë "Artyka II" shpk dhe 74.8 % për shoqërinë "Sireta 2 F" shpk. Në nenin 74 pika 2 të VKM 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku thuhet se "Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. ” Ne kemi hartuar kontratën e mësipërme të bashkëpunimit noteriale.

Kontrata e mësipërme, megjithëse është hartuar si një dokument i nevojshëm juridik i parashikuar nga neni 74 pika 2 e VKM-së për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik si një grup ofertuesish në vetvete është një kontratë juridike (veprim juridik) dhe për interpretimin e saj duhet ti drejtohem Kodi Civil ku konkretisht në nenin 681 dhe 682 të tij parashikohet se 681/ Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në teresi, para e pas përfundimit të kontratës.

Neni 682 “Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tereisia e aktit. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.”

Në rastin konkret, në interpretim të kontratës së mësipërme, qëllimi dhe synimi i shoqërive pjesëmarrëse është ndarja e punimeve dhe pjesëmarrësja në këtë bashkim me 25.2 % për shoqërinë "Artyka II" shpk dhe 74.8 % për shoqërinë "Sireta 2 F" shpk. Kjo gjë vihet re fare, mirë, pasi ne si shoqëri në kontratën e mësipërme kemi deklaruar dhe zërat konkretë të punimeve që ka marrë secila shoqëri pjesëmarrëse dhe po ti referohemi preventivit të punimeve, zërat e marrë përsipër nga shoqëria Artyka II shpk dhe të deklaruara në kontratën e bashkëpunimit përbëjnë 25.2 % të totalit të punimeve. Ndaj dhe kapaciteti teknik, ekonomik dhe ligjor në përputhje me nenin 74 pika 3 e VKM-së plotësohen nga ky bashkim sipas përqindjes së sipërcituar. Ndaj, referuar interpretimit të kontratës parashikuar edhe nga Kodi Civil, kontrata e mësipërme do të interpretohet duke sqaruar se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.”

Nënvizojmë se shoqëritë tona pjesëmarrëse kanë hartuar kontratën duke patur paraysh vetëm përqindjen e mësipërme e cila shprehet:

1.Në vlerën e punimeve të deklaruar në nenin 4 të kontratës ku shoqëria Artyka II shpk ka marrë përsipër vetëm 25.2 % të punimeve

2.Në vlerën e punimeve të deklaruar në nenin 4 të kontratës ku shoqëria Sireta 2 F shpk ka marrë përsipër vetëm 74.8 % të punimeve

3.Po ti referohemi dokumentacionit të dorëzuar për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, shoqëria "Sireta 2 F" shpk plotëson 74.8 % të kapacitetit teknik ekonomik (numri i punonjësve, kapaciteti teknik, ekonomik dhe dëshmitë e eksperiencës së ngjashme) dhe po 25.2 % i këtij kapaciteti total të kërkuar plotësohet nga shoqëria "Artyka II" shpk.

Gjithashtu në nenin 689 të Kodit Civil thuhet se "Kur, me gjithë zbatimin e normave të parashikuara në këtë kre, kontrata mbetet e errët, kjo duhet të merret në kuptimin më pak të rënduar për të detyruarin, po qe se është pa shpërblim, dhe në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, po qe se është me shpërblim." Pra edhe në rastin se kontrata do të ishte e errët, pra nuk do të ishte e qartë mbi mënyrën e interpretimit të saj (megjithëse qartësisht kuptohet qëllimi ynë se 25.2 % e punimeve janë për shoqërinë "Artyka II" shpk sërish ju nuk mund të skualifikoni shoqërinë tonë, pasi referuar rregullave të interpretimit parashikuar nga Kodi Civil, kontrata do të interpretohet në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme.

Gjithashtu mendojmë se një lapsus kalemi nga ana e noterit në të cilën në një paragraf shtues të kontratës deklarohet një përqindje tjetër 45.8 % dhe 54.2 % për secilën shoqëri nuk mund të bëjë të pavlefshëm kontratën në tërësi dhe veprimin juridik në veçanti.

Në nenin 92 të Kodit Civil thuhet se Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)

Në rastin konkret ne nuk jemi para pavlefshmërisë së veprimit juridik, por para lapsus kalemi të bërë nga noterja.[...]"

II.6.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 20037/2 Prot. datë 22.05.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues "SIRETA 2F" sh.p.k & "ARTYKA II" sh.p.k., duke mos e pranuar asnjë prej pikave të ankesës së tij, si dhe ka lënë në fuqi të gjitha arsyet e skualifikimit të vendosura nga KVO, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, KSHA e ngritur pranë autoritetit kontraktor, ka shtuar një tjetër arsye skualifikimi për këtë operator ekonomik, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...] Pas verifikimeve të realizuara në sistemin elektronik të vënë në dispozicion nga APP, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstatoi se në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017, në nenin 4 të saj "pjesëmarrja" janë përcaktuar dy vlera të ndryshme të pjesëmarrjes të shprehura në përqindje, përkatësisht për secilën shoqëri:

Në piken 4.1 të nenit 4 është përcaktuar që shoqëria "ARTYKA II", do të kontribuojë në masën 25.2% në këtë pjesëmarrje, ndërsa shoqëria "Sireta 2F" do të kontribuojë në masën 74.8 %, ndërkohë në paragrafin vijues të këtij neni përcaktohet që shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë kontratë, do të kontribuojnë edhe me fuqinë punëtorë dhe mjetet e makineritë që do të vënë në dispozicion për kryerjen e punimeve, pra 45.8 % e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria "Sireta 2F ndërsa 54.2% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria "ARTYKA II" shpk.

Për sa më sipër, duke ju referuar Kreut VIII, Neni 74, pika 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), në të cilin përcaktohet se "Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje

të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/fumizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi

Bashkimi i operatoreve “Sireta 2F” dhe “ARTYKA II”, nuk kanë përmbushur kërkesat që përcakton neni i mësipërm, duke e bërë të pamundur interpretimin e kësaj kontrate. KSHA gjykon se në Kontratën Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017, për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, janë përcaktuar dy vlera të ndryshme të pjesëmarrjes të shprehura në përqindje, të cilat bien ndesh me njera tjetrën, duke e bërë të pamundur përlllogaritjen nga Autoriteti Kontraktor, për Kriteret e Veçanta të Kulitikut, të përcaktuara për këtë procedurë, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë.

Duke ju referuar përqindjes së pretenduar nga ana juaj, pra “Sireta 2F” shpk - 74.8 % dhe “Artyka II” shpk 25.2 %, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, konkludon sa më poshtë:

Shoqëria “Sireta 2F” shpk ne vertetimin e paraqitur nga Administrata Tatimore si dhe në listë pagesat e paraqitura për periudhën Shkurt 2016 - Shkurt 2017, rezulton të ketë një numër mesatar prej 58 punonjësish. Referuar Kontratës për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive me Nr. 3530 Rep., Nr. 2932 Kol. të lidhur me date 28.04.2017 midis shoqërisë “Artyka II” shpk & “Sireta 2F” shpk ku shoqërite kane rënë dakort që përqindja e pjesëmarrjes në punë të jetë si më poshtë:

Artyka II shpk-25.2 %

Sireta 2F shpk -74.8 %

Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit si dhe referuar VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VIII, Neni 74, pika 3 ku citohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, rezulton se shoqëria “Sireta 2F” shpk duhet të ketë një numër mesatar prej 52 punonjësish për realizimin e kontratës me sukses.

Ndërkohë shoqëria “Sireta 2F” shpk ka lidhur me Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratën me objekt: “Rikonstruksioni i Kopshtit Nr. 55”, ku numri i punonjësve të kërkuar ka qënë 25 punonjes të cilët janë angazhuar për realizimin e këtij objekti, punime të cilat ende nuk kanë përfunduar dhe kontratën me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme Zall Herr” ku numri i punonjësve të kërkuar ka qënë 20 punonjës të cilët janë angazhuar për realizimin e këtij objekti, kontratë për të cilën është paraqitur dokumentacioni për inicimin e procedurës për shtesë kontrate, pra në total rezultojnë 45 punonjës të anagazhuar. Pra në diferencë punonjësish me ata të angazhuar për realizimin e kontratës të sipërcituar, shoqërisë i ngelen vetëm 13 punonjës. Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Kreu VIII, Neni 74, pika 3, ku ndër të tjera përcaktohet se: “ kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë" bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....[...]”

II.6.3. Në datën 02.06.2017 pala ankimuese BOE “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II”sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7. Në datën 07.06.2017 dhe 08.06.2017, autoriteti kontraktor me anë të shkresave nr.22153/1prot., datë 06.06.2017, nr.22297/1prot., datë 07.06.2017 dhe nr.22298/1 prot., datë 07.06.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “CURRI” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “[...]Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit teknik: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm”, pasi për mjeken e shoqërisë nuk ka paraqitur Librezën e Punës dhe CV. [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr. 10, pika 8 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“8.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimes “CURRI” sh.p.k ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë shërbimi individuale me kohë të pjesëshme, datë 28.09.2016, me objekt punësimi me kohë të pjesëshme i znj. V.L me funksion mjekë, me punëdhënëse Shoqëria “CURRI” sh.p.k. dhe punëmarrës znj. V.L., me afat vlefshmërie 1 vit.
2. Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, për znj.V.L, dega Mjekësi e Përgjithshme.
3. Liçensë për ushtrimin individual të profesionit për mjekë, datë 27.09.2016, lëshuar nga Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë, (Këshilli Rajonal Shkodër), për znj. V.L..

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k., nuk ka dorëzuar librezën e punës dhe CV-në e mjekut i cili është pjesë e stafit të tij. KPP thekson se autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 10, pika 8 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ndër të tjera, ka kërkuar në mënyrë eksplicite që për mjekun e përgjithshëm që disponojnë në stafin e tyre, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin librezën e punës dhe CV-në. Bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këto kushte, KPP gjykon se ndodhemi para faktit që operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur shtojcën nr. 10, pika 8 “Kapaciteti teknik”, në mënyrën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk janë dorëzuar dy dokumente të kërkuara. KPP gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, për sa kohë kriteret janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Pra, kur operatorët ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi nuk dorëzojnë një ose më shumë dokumente të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e tyre, bazuar në nenin 46, pika 1, dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

III.1.7. Në rast se operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika

1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Përsa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se “Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 16, germa d) të Kapacitetit teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.”, pasi për Autobotin me targë SH4082E nuk ka paraqitur foto.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr. 10, pika 16, germa d “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.”

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin, për mjetin tip “Autobot”, i kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikën 16 të shtojcës 10, si më poshtë:

- Leje Qarkullimi nr. SHF0335814, Targë SH4082E;
- Certifikatë nr.37, datë 07.02.2017, “Transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit”, lëshuar për automjetin SH4082E;
- Liçencë nr.09, datë 26.01.2017, “Transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit”, lëshuar për automjetin SH4082E;

- Dëshmi për pagesën e taksës vjetore të mjeteve, për automjetin me targë SH4082E, lëshuar nga DPSHTRR;
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, me afat vlefshmërie 01.07.2016-30.06.2017, lëshuar për mjetin motorrik me targë SH4082E;
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, me afat vlefshmërie deri në datën 27.05.2017, lëshuar nga SGS, për mjetin rrugor me targë SH4082E;
- Certificate e pronësisë së mjetit rrugor SH0012660, për automjetin targë SH4082E;
- Pasaportë verifikim autoboti. Nr. Serial 000228, miratuar me Vendim nr.9, datë 28.06.2013, lëshuar për mjetin me targë SH4082E.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriteve të veçanta të kualifikimit, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k., realisht nuk ka dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimeve foton e mjetit Autobot të deklaruar me targë SH4082E, në kundërshtim me çka është kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 10, pikën 16, germa d “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa për paraqitjen e fotove për mjetet e deklaruara, ka si synim kryesor paraqitjen e një panorame të qartë të operatorit ekonomik pjesëmarrës kundrejt autoritetit kontraktor, lidhur me kryerjen me sukses të kontratës. Në këto kushte, KPP gjykon se mos dorëzimi i një dokumenti të kërkuar ose dorëzimi i një dokumenti jo në mënyrën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në DST, bazuar në nenin 46, pika 1, dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, përbën shkak për skualifikim.

III.2.7. Në rast se operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatori ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2.8. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “CURRI” shpk për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e parë të operatorit ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “[...] Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk nuk plotëson pikën 2.2 të Kapacitetit teknik: “Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 80,022,957 (tetëdhjetë milion e njëzet e dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

dhe konkretisht: 320,091,826 (treqind e njëzet milion e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve te sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”, pasi për punën e ngjashme nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.[...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr. 10, pika 1 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 80,022,957 (tetëdhjetë milion e njëzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 320,091,826 (treqind e njëzet milion e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë sipërmarrje e lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik ”VICTORIA INVEST” sh.p.k. me objekt: “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”, nr.8169/1prot., datë 26.08.2013;
2. Akt-Marrëveshje nr.10650/2prot., datë 15.08.2014, për shtyrjen e afatit për përfundimin e punimeve për objektin “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”;
3. Akt-Marrëveshje nr.1238/1prot., datë 23.01.2015, për shtyrjen e afatit për përfundimin e punimeve për objektin “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”;
4. Situacion përfundimtar datë 23.09.2015, për objektin “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”;
5. Akt-Kolaudimi tekniko-ekonomik i objektit “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”, datë 01.10.2015;
6. Faturë tatimore shitje nr.serie 09895515, datë 10.12.2013 (Situacion pjesor I);
7. Faturë tatimore shitje nr.serie 09895525, datë 31.03.2014 (Situacion pjesor II);
8. Faturë tatimore shitje nr.serie 09895538, datë 07.07.2014 (Situacion pjesor III);
9. Faturë tatimore shitje nr.serie 09890669, datë 12.01.2015 (Situacion pjesor IV);
10. Faturë tatimore shitje nr.serie 13559389, datë 16.07.2015 (Situacion pjesor V);
11. Faturë tatimore shitje nr.serie 13559450, datë 01.04.2016 (Situacion përfundimtar);
12. Shtojca 8 Formular Vlerësimi, lëshuar nga Bashkia Tiranë, me objekt kontrate “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11”;
13. Proces-Verbal datë 14.04.2016, “Për marrjen në dorëzim dhe mirëmbajtje të investimeve në rrjetin e ndricimit public dhe disa element që plotësojnë rrjetin e ujësjellësit, KUB e KUZ në objektin: Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina”.
14. Kontratë për punë publike, lidhur ndërmjet Bashkia Elbasan dhe operatorit ekonomik ”VICTORIA INVEST” sh.p.k., datë 11.07.2014, me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës

- “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa””;
15. Amendamenti i kontratës së sipërmarrjes nr.1552/37prot., datë 11.03.2015, me objekt shtesë fondi për objektin “Sistemim-asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa””;
 16. Shtojca 8 Formular Vlerësimi, lëshuar nga Bashkia Elbasan, me objekt kontrate “Sistemim-asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa””.
 17. Situacion përfundimtar për objektin “Sistemim-asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa””
 18. Akt-Kolaudimi për punimet e kryera në objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa””;
 19. Akt-marrje në dorëzim për punimet e kryera në objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa””;
 20. Faturë tatimore shitje nr.serie 09895546, datë 31.08.2014 (Situacion pjesor I);
 21. Faturë tatimore shitje nr.serie 09895549, datë 30.09.2014 (Situacion pjesor II);
 22. Faturë tatimore shitje nr.serie 09895550, datë 28.10.2014 (Situacion pjesor III);
 23. Faturë tatimore shitje nr.serie 13559451, datë 02.11.2014 (Situacion pjesor IV);
 24. Faturë tatimore shitje nr.serie 13559441, datë 05.01.2016;

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.3.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.3.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat,

në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Neni 26, pika 6 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon : *“a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve. ”*

III.3.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues ”VICTORIA INVEST” sh.p.k. në mënyrë elektronike në SPE, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur dy kontrata të sukseshme sipërmarrje me autoritete kontraktore për punë të ngjashme, përkatësisht “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”, me autoritet kontraktor Bashkia Tiranë, me vlerë punimesh të realizuar 208,303,692 lekë me TVSH ose 166,642,953.6 lekë pa TVSH dhe “Sistemim-asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa”, me autoritet kontraktor Bashkia Elbasan me vlerë punimesh të realizuar 100,663,850 lekë me TVSH ose 80,531,080 lekë pa TVSH. Gjithashtu, KPP konstaton se secila kontratë e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, e tejkalon vlerën prej 50% të fondit limit (80,022,957 lekë) të kontratës objekt prokurimi. Për këtë arsye, pavarësisht se proces-verbali datë 14.04.2016, “Për marrjen në dorëzim dhe mirëmbajtje të investimeve në rrjetin e ndricimit publik dhe disa element që plotësojnë rrjetin e ujësjellësit, KUB e KUZ në objektin: Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina”, nuk është për marrjen në dorëzim e të gjithë objektit të kontratës “Rikualifikim Urban i Bllokut mbi Shina, Njësia Bashkiake Nr.11 “Faza 1”, KPP gjykon se kriteri i vendosur në shtojcën nr. 10, pika 1 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi është përmbushur na operatori ekonomik ankimues me dorëzimin e kontratës të sipërmarrjes me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugës Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa”, me autoritet kontraktor Bashkia Elbasan, kontratë e cila është dorëzuar me të gjithë dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga autoriteti kontraktor: Shtojca 8, Formulari Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Elbasan; Situacion përfundimtar; Akt-Kolaudimi dhe Akt-marrje në dorëzim. Sa më sipër, KPP gjykon se arsyeja e skualifikimit e ngritur nga autoriteti kontraktor që për punën e ngjashme nuk ka paraqitur certifikatën e marrjes në dorëzim nuk qëndron, pasi për objektin “Sistemim-asfaltim i rrugës Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa”, operatori ekonomik ankimues e ka dorëzuar aktin e marrjes në dorëzim si dhe formularin e vlerësimit e cila tregon certifikimin e punimeve nga vetë investitori i saj, Bashkia Elbasan.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”VICTORIA INVEST” sh.p.k., qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “Operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”, pasi për fadromat përvec faturës së zhdoganimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr.10, pikën 16, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkuese minimumi 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion veteshkarkuese minimumi 10 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri skarifikim shtresa	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul me kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetonierë	2 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri vijëzimi me bojë bikomponente	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë;
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë.

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet

me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te qera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).”*

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë blerje nr.2089276, datë 30.12.2008, për blerjen e eskavatorit me goma të markës CASE, tip 788P ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me goma të markës CASE, tip 788P ;
- Dy foto të eskavatorit me goma të markës CASE, tip 788P ;
- Faturë blerje nr.2089330, datë 30.01.2009, për blerjen e eskavatorit me goma të markës CASE, tip 788P2A ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me goma të markës CASE, tip 788P2A ;
- Dy foto të eskavatorit me goma të markës CASE, tip 788P2A ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me goma të markës NEË HOLLAND, tip ËE210 ;
- Dy foto të eskavatorit me goma të markës NEË HOLLAND, tip ËE210 ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin e markës CASE, tip CX135SR ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me zinxhirë i markës HITACHI, tip ZX350 ;
- Një foto të eskavatorit me zinxhir të markës HITACHI, tip ZX350 ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me zinxhirë i markës HITACHI, tip ZX280LCN-3 ;
- Dy foto të eskavatorit me zinxhirë i markës HITACHI, tip ZX280LCN-3 ;
- Fature blerje nr.400373, datë 02.02.2009, për blerjen e eskavatorit me zinxhir të markës VOLVO, tip EC210BLC ;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me zinxhirë i markës VOLVO, tip EC210BLC ;
- Një foto të eskavatorit me zinxhir të markës VOLVO, tip EC210BLC
- Fature blerje nr.546035, datë 23.01.2008, për blerjen e eskavatorit me zinxhir të markës VOLVO, tip EC280 ;
- Një foto të eskavatorit me zinxhir të markës VOLVO, tip EC280;
- Faturë zhdoganimi për eskavatorin me zinxhirë i markës VOLVO, tip EC280 ;

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.4.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.4.5. Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.4.6. Nga shqyrtimi dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht nga operatori ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k, si dhe bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me transportin rrugor në Republikën e Shqipërisë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, pikat 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 113 i Ligjit Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikojnë: *“2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit; 3. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8; 4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit; 5. Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.”* Nga interpretimi literal i nenit të sipërcituar, konstatohet qartë se për regjistrimin e mjeteve teknologjike në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor si dhe për pajisjen me targë njohjeje, leje qarkullimi dhe gjithë dokumentacionin lidhur me to, detyrimi ligjor lind vetëm në rastet kur mjetet teknologjike qarkullojnë në mënyrë vetëlëvizëse në rrugë. Pra, në asnjë rast, legjislacioni në fuqi për transportin rrugor në Republikën e Shqipërisë, nuk detyron pronarët e mjeteve teknologjike që ti regjistrojnë ato pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e për rrjedhojë të pajisen me targë njohjeje, leje qarkullimi etj, për sa kohë ato transportohen me mjete të tjera dhe përdoren vetëm në kantier. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të disponueshmërisë së makinerive tip eksavator me goma, shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në zbatim të kriteve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, sipas pikës 16/b të shtojcës 10 të dokumentave të tenderit, pasi për sa kohë mjetet ekavator me goma që disponon operatori ekonomik ankimues nuk janë të regjistruara në regjistrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nuk kanë si të pajisen me targë njohjeje e si rrjedhojë me dokumentacionin përkatës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “VICTORIA INVEST” sh.p.k., qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e parë të BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II”sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson pikën 3 të Kriterëve të Përgjithshme të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur. Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme”, pasi në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017, në nenin 4 të saj ‘pjesëmarrja’ janë përcaktuar dy vlera të ndryshme të pjesëmarrjes të shprehura në përqindje, përkatësisht për secilën shoqëri cka bie në kundërshtim me Kreut VIII, Neni 74, pika 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1. Në shtojcën nr. 10, “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar : *“Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur. Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen: a.Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b.Prokura e posaçme.”*

III.5.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive lidhur midis shoqërisë ”SIRETA 2F” sh.p.k. dhe shoqërisë “ARTYKA II” sh.p.k., datë 28.04.2017, nr.3730rep., nr.2932kol.
2. Prokurë e posaçme, datë 28.04.2017, nr.3730/1rep, nr.2932/1kol., me anë të së cilës shoqëria “ARTYKA II” sh.p.k. autorizon shoqërinë ”SIRETA 2F” sh.p.k., që ta përfaqësojë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.5.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.5.5. Nga shqyrtimi dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht nga BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II”sh.p.k., KPP konstaton se në nenin 4.1 “Pjesëmarrja” të kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm është përcaktuar se shoqëria “ARTYKA II” sh.p.k. do të kontribuojë në masën 25.2 %, duke marrë përsipër të realizojë 25.2% të punimeve, përkatësisht në pikën A-2-Punime në Trup të Rrugës do të realizjë, pikat A-2/7; A-2/8; A-2/12 dhe A-2/13 të preventivit të punimeve, ndërsa shoqëria ”SIRETA 2F” sh.p.k. do të kontribuojë në masën 74.8 % duke marrë përsipër të realizojë të gjithë zërat e tjerë të punimeve sipas preventivit të punimeve. Gjithashtu, KPP konstaton se në të njëjtin nen të kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm është përcaktuar: #

“Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë kontratë, do të kontribuojnë edhe në fuqinë punëtore dhe me mjetet dhe makineritë që do të vënë në dispozicion për kryerjen e punimeve, pra 45.8% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “SIRETA 2F” sh.p.k, ndërsa 54.2% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “ARTYKA II” sh.p.k. ”.

III.5.6. Referuar dokumentacionit të administruar, legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, si dhe pretendimet e palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se në pikën 1 dhe 3 të nenit 74 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.”*; *“3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”*. Bazuar në interpretimin literal të neneve të sipërcituar, KPP gjykon se operatorët ekonomik të cilët vendosin të konkurojnë të bashkuar në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën ka detyrimin të përcaktojë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë. Në rastin konkret, detyrimi i vetëm ligjor që duhet zbatuar në mënyrë që kjo kontratë bashkëpunimi të konsiderohet e vlefshme konsiston në deklarin në përqindje të punëve si dhe i zërave konkret të preventivit të punimeve që secili operator ekonomik merr përsipër të kryej. Ndërsa në lidhje me përmbushjen e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, nuk është e detyrueshme që të deklarohet përqindja e kontributit, pasi bazuar në nenet e sipërcituara, ato përllogariten në mënyrë përpjestimore me përqindjen e deklaruar për punët që do të kryej gjithsecili. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa kohë kontrata e bashkëpunimit e dorëzuar elektronikisht nga operatori ekonomik ankimues plotëson kushtet formale të cilat janë: *lidhja përpara noterit; deklarimi i përqindjes së pjesëmarrjes në punë; nënshkrimi i rregullt i palëve etj.*, nuk mund të konsiderohet e parregullt dhe si pasojë të përbëjë shkak për skualifikimin e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, pasi deklarimi se 45.8% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “SIRETA 2F” sh.p.k, ndërsa 54.2% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “ARTYKA II” sh.p.k., konsiderohet një deklarin shtesë jo i domosdoshëm dhe si i tillë nuk duhet të merret në konsideratë, qoftë ky deklarin i saktë apo jo.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II”sh.p.k. qëndron.

III.6. Lidhur me arsyen e dytë dhe të tretë të skualifikimit të BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson pikën 2.2 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që*

prokurohet dhe konkretisht: 80,022,957 (tetëdhjetë milion e njëzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 320,091,826 (treqind e njëzet milion e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten të kualifikueshme, pasi referuar kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017 ku paraqiten vlera të ndryshme të pjesëmarrjes së secilit operator të shprehura në përqindje duke e bërë të pamundur përlllogaritjen e vlerave të punës së ngjashme për secilin, Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson pikën 4 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Një punësim mesatar i të paktën 70 (shtatëdhjetë) personave, për periudhën shkurt 2016 – shkurt 2017, të vërtetuar me”, pasi referuar kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, noterizuar me Nr.3930.Rep, Nr.2932.Kol, datë 28.04.2017 ku paraqiten vlera të ndryshme të pjesëmarrjes së secilit operator të shprehura në përqindje duke e bërë të pamundur përlllogaritjen e numrit të punonjësve për secilin.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, sikurse është arsyetuar edhe në pikën e mësipërme, në rastin konkret, detyrimi i vetëm ligjor që duhet zbatuar në mënyrë që kjo kontratë bashkëpunimi të konsiderohet e vlefshme konsiston në deklarin në përqindje të punëve si dhe i zërave konkret të preventivit të punimeve që secili operator ekonomik merr përsipër të kryej dhe në lidhje me përmbushjen e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, nuk është e detyrueshme që të deklarohet përqindja e kontributit, pasi bazuar në nenet e sipërcituara, ato përlllogariten në mënyrë përpjestimore me përqindjen e deklaruar për punët që do të kryej gjithsecili. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përse kohë në kontratën e bashkëpunimit të dorëzuar elektronikisht nga BOE ankimes është pasqyruar deklarimi në përqindje të punëve si dhe i zërave konkret të preventiv të punimeve që secili operator ekonomik merr përsipër të kryej, nuk mund të konsiderohet e parregullt dhe si pasojë të përbëjë shkak për skualifikimin e këtij bashkimi operatoesh ekonomik, pasi deklarimi se 45.8% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “SIRETA 2F” sh.p.k, ndërsa 54.2% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “ARTYKA II” sh.p.k., konsiderohet një deklarin shtesë jo i domosdoshëm dhe si i tillë nuk duhet të merret në konsideratë, qoftë ky deklarin i saktë apo jo. Autoriteti kontraktor ka detyrimin që të kryej përlllogaritjet në lidhje me përmbushjen e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike në bazë të përqindjes të deklaruar për punët që do të merren përsipër nga secili pjestarë i bashkimit dhe cdo deklarin të tepërt duhet ta konsiderojë nul. Vlen të theksohet se gjatë fazës së vlerësimit, komisioni i vlerësimit të ofertave i procedurës objekt shqyrtimi, nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit të dorëzuar nga ana e BOE “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k. për të përmbushur kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor në pikat 2.2 dhe 4 të kapacitetit teknik në dokumentat e tenderit, por është përmbajtur vetëm në pamundësinë për të kryer përlllogaritjen e vlerave të punës së ngjashme dhe numrit të punonjësve për secilin. Sa më sipër, KPP gjykon se përse kohë gjatë fazës së vlerësimit, komisioni i vlerësimit të ofertave i procedurës objekt shqyrtimi, nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit të dorëzuar, si dhe bazuar në faktin që autoriteti kontraktor e ka patur mundësinë për të kryer përlllogaritjet e nevojshme sipas interpretimit të mësipërm, këto dy arsye skualifikimi nuk qëndrojnë.

III.6.1. Lidhur me pretendimet e shtuara nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues për mos plotësim të kritereve të veçanta të kualifikimit, K.P.P. vëren se:

III.6.2. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”*. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”* Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”*. Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës. kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjyeshërisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.”* Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *[...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.**

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 9 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka dalë jashtë tagrave dhe kompetencave të dhëna nga ligji dhe se K.P.P. nuk mund të gjykojë mbi pretendime shtesë për skualifikimin e ofertës ngritur nga autoriteti kontraktor në momentin e shqyrtimit administrative të ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “CURRI” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rikonstruktion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga “Besa” – “Siri Kodra” – “Zenel Bastari” – “Haki Rexhep Kodra” (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike*”, me nr. REF-02194-04-03-2017, me fond limit 160,045,913 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “VICTORIA INVEST” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e BOE ankimues “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Të anullojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “VICTORIA INVEST” sh.p.k. dhe BOE “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet duke i kualifikuar këta operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “VICTORIA INVEST” sh.p.k. dhe BOE “SIRETA 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1039 protokoli Datë 31.05.2017; Nr. 1055 protokoli Datë 02.06.2017;

Nr. 1049 protokoli Datë 01.06.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha